

2 Zvicra perëndimore me KKP të kopshtarisë Marrëvshje historike falë partnerëve social

3 Përfshirje në vend të diskriminimit Të drejta themelore dhe siguri për të gjithë!

4 Arsimimi profesional PROGRESSO Mundëson karrierën profesionale për migrantet

Nr. 6 | Tetor 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

«Tani është radha jonë!» Demonstrata me 30 tetor

Kërkohet më shumë pagë, respekt dhe solidaritet



Nevojitet një mirënjohje e vërtetë për përpjekjet e punonjës*eve edhe përgjatë pandemisë

«Tani është radha jonë!» - Ky është slogani i demonstratës ndërprofesionale dhe të decentralizuar më 30 tetor 2021. Grumbullimet do të bëhen në Cyrih, Olten, Bernë, Gjenevë edhe Belinzona. Kështu ne do të paraqitemi me kërkesat tona për solidaritet në të njëjtën kohë nëpër rrugët e shumë qyteteve. Së bashku me ju!

Artan Islamaj

Një vit e gjysmë që kaloi ishin të jetë sfiduese. Para së gjithash për të gjithë ata. Të cilët nuk kishin mundësi të kryen punën nga shtëpia (Homeoffice) dhe të merrnin pagat e tyre të rregullta.

Puna nën kushte të rënda

Punëtor*et në ndërtimtari, në zejтари dhe në industri gjatë pandemisë ishin të detyruar të punonin pandërprerë e nën kushte më të vështira. Në gastronomi në rend dite ishin shkurtimet e konsiderueshme të pagave – shumë veta humbën edhe vendet e tyre të punës. Jo më pak të prekura janë profesionet shërbyese: Punëtor*et e kujdesit, e shitjes, e logjistikës dhe pastrimit gjatë kohë së krizës së koronës, të konsideruara si esenciale dhe «me rëndësi relevante për sistemin», por pagat në këta sektorë janë mesatarisht ende shumë të ulëta, edhe ngase në tendencë më shumë ushtrohen nga gratë.

Ndokush tani mund të mendojë se kërkesat për kushte më korrekte pune dhe paga më të larta në rrethanat e COVID-19 janë të pavend. Por nëse shikohen dividendët e vitit 2020, kompanitë zvicerane u kanë paguar aksion*eve të tyre rreth 42 miliardë

dollarë. Para ka. Mirëpo ato ndahen pa korrektësi! Kjo nuk është befasisë, pasi që ne me qindra vjet kemi ndarje të qartë të klasave. Sidoqoftë, duhet të theksohet se pandemia nuk është një «barazues», por vetëm ka nxjerrë në dritë mospërputhjen brenda shoqërisë dhe gjithashtu e ka promovuar pabarazinë në mënyrë efektive. E gjitha kjo mbi supet e punëtor*eve!

Ne kërkojmë!

Andaj, me 30 tetor ne themi «Tani është radha jonë!» dhe ne kemi kërkesa:

- Njohje e vërtetë e përpjekjeve të bëra nga punonjësit gjatë pandemisë me më shumë paga (të paktën 4000 franga × 13) dhe rritje pagash për të gjithë.
- Më shumë respekt për gratë që punojnë në shitje dhe në përkujdesje me futjen e marrëveshjeve kolektive të punës me detyrim të përgjithshëm.
- Vende të sigurta pune si dhe kantiere të pastra dhe të organizuara mirë në ndërtimtari dhe zejtari. Nevojitet më shumë kohë dhe është koha që presioni i afateve gjithnjë e më të ngushta të merr fund!
- Reduktim stresi përmes planifi-

kimit të qëndrueshëm, pa punë me thirrje afatshkurtër, reduktim të orarit të punës në vend të reduktimit të personelit; jo çrregullimit të orarit të hapjes në shitje apo për shërbimet tjera.

■ Jo rritjes së moshën e pensionit për gratë! Parlamenti dëshiron të rrisë moshën e pensionit të AHV/AVS në 65 vjeç për gratë, edhe pse diskriminimi i pagave edhe më tej ka shënuar rritje. Kjo sjellje është mospërnjohëse për gratë që punuan në vijat e para gjatë krizës.

Eja edhe Ti me ne, të dalim në rrugë për të demonstruar për shqetësimet tua. Merr me vete miqtë tu, kolegët e punës dhe bashkëmendimtarët. Secili/a kontribuon me pjesëmarrje! Secili/a votë numërohet!

Unia merr përsipër kostot e transportit për secilin pjesëmarrës dhe organizon shujtën. Këtu mund të gesh të gjitha informacionet në lidhje me demonstratën dhe gjithashtu mund të regjistrohesh në tek regjioni yt: www.solidaritaet.unia.ch/demo

INFOGRAFIKA SPECIFIKE:

Gjenevë, Grumbullimi në ora 13.00, në Place des Vingt-Deux-Cantons, fillimi i demonstratës në ora 13.30

Olten, Grumbullimi në ora 13.00, në Bifangstrasse, fillimi i demonstratës në ora 13.30

Cyrih, Grumbullimi në ora 13.00, në Helvetiaplatz, fillimi i demonstratës në ora 13.30

Belinzona, Grumbullimi në ora 13.00, në Piazzale Stazione, fillimi i demonstratës në ora 13.30

+ **Bernë**, Demonstrata e profesioneve të kujdesit dhe shëndetësisë

Editorial



Të bashkuar të tregojmë forcën

Rreth 15000 persona në sheshin federal të Bernës kanë protestuar kundër reduktimit të planifikuar të pensioneve. Sinjali dërguar parlamentit është i qartë: Një parashtrësë mbi pensionet AHV/AVS në kurriz të grave do të përballlet me kundërshtimin e vendosur.

Ngjashëm duhet të reagojmë ne mbi parashtrësën e padrejtë dhe diskriminuese. Të gjithë ata që me 18 shtator ishin në Bernë kanë ndier energjinë pabesueshme. Ne përmes raportimeve të mediave kemi arritur që njerëzit në të gjithë Zvicrën dhe kemi bërë të qartë padrejtësinë kësaj «reformë». Reagimi ishte i fuqishëm dhe i qartë. Mirëpo, kjo nuk mjafton. Ne nuk duhet të mbrohemi vetëm kundër sulmeve karshi të drejtave tona. Ne duhet të marrim iniciativën. Pandemia na ka treguar të gjithëve se ku qëndrojnë pabarazitë. Pakot e masave gjatë kohëve të vështira kanë ndihmuar shumë ndërmarrje. Të tjerë kishin mundësi të vazhdonin të kryenin punën e tyre në shtëpi (Homeoffice). Shumë të tjerë qëndruan në vij të parë të frontit: të punësuarit në sektorët esenciale, në ndërtimtari, në zejtari dhe në industri janë goditur rëndë nga kriza e koronës. Duartrokitja është mirë, mirëpo ajo nuk është mjaftueshme. Në kërkojmë kushte më të mira pune dhe paga më të mira. Presioni i terminëve dhe fleksibiliteti me çdo çmim duhet të marrin fund! Punëdhënësit duhet përfundimisht të bëjnë kontrata më të mira pune në shitje, në kujdes, në logjistikë dhe në sektorët tjerë esenciale, në të cilët janë duke punuar në shumicë gratë. Për këtë ne do të demonstrojmë me 30 tetor në Gjenevë, Olten, Cyrih, Belinzona dhe në Bernë. Lajmërohuni dhe bëhuni edhe ju pjesë e një lëvizjeje të fuqishme për solidaritet dhe drejtësi.

Marek Wieruszewski

News

Angazhimi i Unia kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit të fuqisë punëtore dhe punës së detyruar

Që nga 2006 janë ekzekutuar më pak se 10 dënime. Pasi që ai ka keqtrajtuar punonjësit e tij në shumë kantiere në Gjenevë, Vadit dhe Valis nga viti 2014 deri 2017, një sipërmarrës ndërtimtarie u dënua vitin e kaluar me 6 vjet burg shkaku i trafikimit zejtar të njerëzve dhe fajdesë. Njëri nga mbrojtësit është më shumë se 10 vjet anëtarë i Unia. Ky rast bënë të qartë se për çka e kemi flasin, kur e kemi fjalën për trafikim me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit të fuqisë punëtore: ditë pune 10 orësh, 6 ditë në javë, strehim jo të shëndetshëm, orë punë nga 6.50 franga deri 20 Rp. (Cent)... Çka duhet të ndërmerrni nëse keni ndonjë dyshim, pyetje, apo pasiguri në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore? Çka mund të bëhet kundër kësaj dukurie? Informacione të mëtejme mund të gjeni në ueb faqen tonë: unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/menschenhandel

Marrëveshje e re ndërkombëtare në industrinë e tekstilit

Pas bisedimeve të vështira me muaj të tërë dhe punës së palodhur në fushatës më në fund është arritur një pajtueshmëri pozitive për punëtor*et e tekstilit. Nga 1.9.2021 vlen zyrtarisht Marrëveshje e re ndërkombëtare (New International Accord for Health and Safety in the Textile and Garment Industry), e cila përbën të gjitha pikat tona të rëndësishme (përgjegjësia individuale, kontrolle të pavarura sigurie, zgjerimi i marrëveshjes për vende tjera). Këtu gjeni vegën mbi Accord-PR, CCC-PR dhe mbi tekstin origjinal të marrëveshjes (bangladesh.wpengine.com/wp-content/uploads/2021/08/1-September-International-Accord-on-Health-and-Safety-in-the-Textile-and-Garment-Industry-public-version.pdf)

Deri më tani marrëveshjen, që është në fuqi nga 1.9.2021, e kanë nënshkruar 80 ndërmarrje mode, ndër to edhe firma zvicerane Tally Weijl si e vetme. Prodhuiesit tjerë zviceranë të rrobave si Chicorée, Coop, INTERSPORT, Mammüt, Manoran dhe Zebra, ende nuk e kanë ndërmarrë këtë hap. Tani është me rëndësi që mundësisht shumë ndërmarrje mode të nënshkruajnë marrëveshjen e re mbi sigurinë e godinës dhe mbrojtjen nga zjarri. Në javët e ardhshme ne do të shqyrtojmë mundësitë, se si mund të ushtrojmë presion karshi ndërmarrjeve zvicerane në fjalë dhe do t'ju informojmë mbi hapat vijues.

Të drejtat e punëmarrësve janë më të rëndësishme se sa liria e ndërmarrësisë

Një firmë në Norvegji donte të punësonte punëmarrës jashtë Kontratës së vlefshme Kolektive të Punës (KKP). Dhe ti paguajë keq. Posa morri vesh sindikata e transportit, vendosi një bojkot, për të detyruar firmën që të detyrojë ti përmbahet KKP-së dhe të punësojë njerëzit sipas kontratës së vlefshme. Firma paditi sindikatën e transportit. Gjyqi i lartë norvegjez vendosi: Përmes bojkotit firma është dëmtuar rëndë në të drejtës e saj themelore përkritazi me lirinë ekonomike. Konteksti gjyqësor shkoi me tej. Gjykata e EFTA gjithashtu morri në mbrojtje firmën. Sindikata norvegjeze e transportit i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) si instancës më lartë. GJEDNJ monitoron respektimin e konventës për të drejtat e njeriut. Gjykimet e saj janë të detyrueshme, gjithashtu edhe në Zvicër. **Më 10 qershor 2021 GJEDNJ mori një vendim historik:** Bojkoti i sindikatës ishte legal. Arsyetimi është i ashpër: liria ekonomike nuk është e drejtë themelore, që është mbi lirinë e bashkimit dhe kështu edhe të drejtave të punëtorëve. Vendimi ka të ngjarë të ketë një ndikim mbi të gjitha në Gjykatën e Drejtësisë të BE-së.

Shumë arsye për bisedime pagash

Nga lulëzimi ekonomik duhet të përfitojnë edhe punëmarrësit!

Që janë të nevojshme bisedimet për pagat, është e qartë: Punëmarrësit duhet të kompensohen për përpjekjet gjatë krizës së koronës. Mirëpo punëdhënësit nuk duan t'ia dinë.

Noémie Zurlinden, ekonomiste e Unia



Ka disa muaj që Zvicra përsëri po shënon një rritje ekonomike. Bisedimet për paga pra janë të mundshme. Punëmarrësit duhet që të kompensohen për përpjekjet e tyre gjatë krizës së koronës, jo së fundi edhe shkaku i punës me kohë të shkurtuar dhe papunësisë kanë pësuar humbje në të ardhura. Kush nuk kishte mundësi të kryejë punën nga shtëpia (Homeoffice), në vendin e punës i ekspozohet rreziqeve shëndetësore. Pos kësaj bisedimet për paga janë të nevojshme për të baraspeshuar shtrenjtimin dhe për të ruajtur fuqinë blerëse. Dhe në fund në sektor të ndryshëm mungojnë punonjës me përvojë. Edhe pse janë përmbyshur të gjitha kriteret për një ngritje pagash, si duket për punëdhënësit këto arsye nuk janë të mjaftueshme.

Shembulli i ndërtimtarisë: Punëdhënësit paraqesin pengesë

Me 6 shtator u zhvilluan bisedime mbi pagat me sipërmarrësit. Sindikata Unia bashkë me Syna, kërkoi 100 franga më shumë pagë. Mirëpo pasi që sipërmarrësit kërkuan shkurtime pagash vitin e kaluar, ata këtë vit mendojnë që ngritja e pagave nuk është e arsyeshme dhe ngulin këmbë për një zero raund.

Kjo është plotësisht e pakuptueshme. Punëtorët e ndërtimtarisë

edhe përkundër rreziqeve shëndetësore kanë punuar pandarë edhe përgjatë krizës së koronës. Falë këtyre përpjekjeve sektorit të ndërtimtarisë i shkojnë punët mirë: Librat e porosive janë përplot dhe përfitimi po rritet. Edhe punonjësit duhet gjithashtu të përfitojnë nga ky sukses (i tyre!).

Punëdhënësit pretendojnë me dëshirë se paga te ulëta sigurojnë vendet e punës. Numri i vendeve të punës megjithatë varet nga kërkesat e përgjithshme ekonomike dhe jo nga pagat. Pos kësaj, pagat më të larta mund të stimulojnë më tej kërkesën dhe kështu rimëkëmbjen ekonomike. Pasi pikërisht edhe sektori i ndërtimtarisë është duke vuajtur nga mungesa personelit profesionistë, duhet që rritja e pagave të jetë atraktive edhe për punëdhënësit: kështu do të ruheshin të arsimuarit e sektorit dhe të tërhiqen fuqi të reja pune. Këtë logjikë si duket nuk duan ta kuptojnë sipërmarrësit.

Në demonstrata me 30 tetor!

Unia organizon me 30 tetor demonstrata të sektorëve të ndryshëm. Mobilizim i fuqishëm dërgon një sinjal të rëndësishëm për bisedime pagash në të gjithë sektorët. TANI duhet të përfitojnë dhe punonjësit nga lulëzimi ekonomik!

Komunikatë e përbashkët për media e partnerëve social

Marrëveshje Kolektive e Punës për kopshtar*et në Zvicrën perëndimore

Një Kontratë Kolektive e Punës (KKP) për kopshtar*et në Freiburg, Neuenburg/Neuchatel, Jura dhe në Jura të Bernës

JardinSuisse Freiburg, Neuenburg/Neuchatel, Jura dhe Jura e Bernës si dhe sindikata Unia, Syna dhe GBS (Profesionet e Gjelbra Zvicra) kanë prezantuar KKP e re për sektorin e kopshtarisë. Kjo marrëveshje historike dëshmon dinamikën e dialogut social në sektorin në fjalë dhe vullnetin e partnerëve social që bashkërisht të kujdesen për kushte pune me dinjitet.

Përmes deklaratës me vlefshmëri të përgjithshme nga 1 gusht 2021 do të zbatohet KKP-ja për të gjithë kopshtar*et

në regjionet Freiburg, Neuenburg/Neuchâtel, Jura dhe Jura e Bernës si dhe në Komunat Biel dhe Evillard-Macolin.

Pagat minimale, paga e 13 mujore, pushim më i gjatë i atësisë se sa është paraparë me ligj, janë disa nga pikat e përmendura, të cilat kujdesen të rregullojnë KKP-në e re e akordim me nevojat dhe shqetësimet të kohës sonë. KKP-ja vlen deri më 2014. Pos kësaj partnerët social duan që përmes rregullave të qarta dhe instrumenteve kontrolluese të luftojnë jo vetëm punësimin abuziv dhe konkurrencën e padrejtë, por edhe të përmirësojnë sigurinë në vendin e punës.

Dhe jo së fundi kjo KKP është dëshmi e një partneriteti konstruktiv dhe të fuqishëm social, i cili gjen vazhdimësi në komisionin e paritetit ndërregjional të krijuar rishtas. Një ndër detyrat e këtij komisioni do të jetë zbatimi i rregullave të reja, njëherit duke informuar dhe shoqëruar ndërmarrjet dhe punonjësit.



Pamje nga një aksion i kopshtar*eve për kushte korrekte pune

Votimet e 26 shtatorit 2021

Po e qartë «Martesën për të gjithë»

Shumica e votues*eve i thanë po – unë dua «Martesë për të gjithë». 64% si dhe të gjitha kantonet votuan për. Në të kundërtën u refuzua nisma për taksimin e kapitalit të rinisë socialiste (Juso). Gati 65% votuan kundër tatimit për më të pasurit. Zgjerimi i të drejtës së votës u rrëzua dukshëm në Uri dhe Solothurn.

Marek Wieruszewski



Tek votues*et e moshë së re aprovimi i «Martesës për të gjithë» ishte 75%. Kështu Zvicra i bashkëngjitet 16 vendeve tjera evropiane të cilat lejojnë martesën mes qifteve të gjinisë së njëjtë. Edhe pse vetëm 1% e popullatës posedon 40% të pasurisë në vend, zvicran*et nuk duan të taksojnë më shumë.

S'ka të drejtë vote për 16 vjeçar*e ...

Në kantonin Uri është refuzuar dukshëm e drejta e votës me 16 vjeç. Kështu Glarus-i mbetet kantoni i vetëm, ku lejohet votimi me 16 vjet.

dhe për të huajt

Të 107 komunat e kantonit Solothurn refuzuan të drejtën vullnetare të votës për të huajt në rrafshin komunal. 75% e votues*eve i thanë jo nismës së majtë. Ky preokupim nuk kishte shans as në qytete. Qytetet Olten dhe Solothurn refuzuan nismën në fjalë me 57%, ndërsa Grenchen deri edhe me 76%.

Konferenca e migracionit 2021 e SGB/USS

Pjesëmarrje në vend prekariteti: të drejta themelore dhe siguri për të gjithë

Në konferencën e migracionit të Bashkimit të Sindikatave Zvicrane (SGB/USS) të 4 shtatorit 2021 60 pjesëmarrës*et janë deklaruar për pjesëmarrje dhe të drejta themelore në vend prekariteti dhe përjashtimi të migrant*eve: Zvicra duhet të ndërmerre gjithçka që të mos ketë më tej përjashtim nga pjesëmarrja politike, shoqërore dhe ekonomike.

Hilmi Gashi

Kriza e Covid-it ka treguar, se sa janë në të vërtetë migrant*et relevant për sistemin, mirëpo megjithatë shpesh mbesin të përjashtuar nga solidariteti shoqëror. Bile edhe më shumë se sa kjo, ata/o dënohen, nëse në rast emergjence kërkojnë mbështetje shtetërore – për shembull asistencë sociale. Por edhe përtej situatave të krizës shanset dhe të drejtat nuk janë njëjtë të ndara. Pandemia si një xham zmadhues ka bërë të dukshëm pasigurinë e përhershme në rritje. Kur njerëzit shkak i preardhjes së tyre përjashtohen nga pjesëmarrja politike, ekonomike, sociale e kulturore, kjo dëmton shoqërinë dhe demokracinë.

Rregullimi i deficitit demokratik

Komisioni i migracionit i SGB/USS ka nisur rishtas debatin: Pjesëmarrës*et kanë zhvilluar bashkërisht vizionet se si Zvicra do të mund të ishte shembull në çështjen e pjesëmarrjes dhe mirëqenies për të gjithë. Paradite referatet ngacmuese u kujdesen për diskutim të thelluar në grupe pune: Juristja Marie Möscher vuri në pah pasojat negative të ashpërimit në ligjin për të huajt*at, ndërsa gazetari Mattia Lento foli për pasojat e krizës së koronës për migrant*et dhe këshilltarja komunale e Bernës Franziska Teuscher tregoi se si qytetet edhe përkundër kufizimeve kantonale e federale përpigën për një

politik solidare të migracionit. Pasdite vazhdoi podiumi me senatorin Paul Rechsteiner e Lisa Mazzone dhe Arbër Bullakaj nga «Aktion Vierviertel» mbi të drejtën në pjesëmarrje politike: E drejta zvicrane e natyralizimit nuk do të duhej të ndodhte përmes përshtatjes, por njerëzve që jetojnë këtu dhe janë pjesë e shoqërisë, tu mundësohet bashkë-ndikimi demokratik. Në fund

të konferencës pjesëmarrësit përmes aprovimit të rezolutës «Varfëria nuk është krim» dhe «Rregullimin e deficitit demokratik» përfunduan kërkesat për siguri ekonomike dhe pjesëmarrje për të gjithë – pavarësisht nga prejardhja dhe kombësia. (sgb.ch/fileadmin/re-daktion/docs/communiqués/210904_SGB_Mig_Konf_Resolutionen_D.pdf)



Gjatë punimeve të Konferencës së Migracionit të Sindikatave të Bashkuara të Zvicrës

Intervista me Marie Moeschler



Diskriminimi i ankoruar ligjërisht

Ligji për të huajt dhe për integrim (AIG/LEI) ka fuqizuar ashpërsimin në të drejtën migrante dhe është diskriminues. Horizonte mbi këtë çështje ka biseduar me Marie Moeschler, juriste e Unia.

Marie, çka rregullon AIG/LEI?

AIG/LEI rregullon hyrjen dhe qëndrimin e qytetar*eve. Të cilët vijnë nga të ashtuquajturat vende të treta. Për qytetar*et e BE/EFTA vlen marrëveshja për lëvizje të lirë të personave. Mirëpo vetëm për aq kohë sa janë në cilësi të punëmarrësve. Nëse janë të paafte dhe të pandërmjetësueshëm për punë, i nënshtrohen AIG/LEI dhe mund të preken njëjtë nga ligji në fjalë.

Çka ndryshon nga më herët AIG/LEI?

Nga 2019 janë futur kriteret të reja integruese. Me rastin e dhënies apo zgjatjes së një lejeje, autoritetet e migracionit bazuar në kriteret të tilla vlerësojnë «integrimin» e migrant*eve. Diçka që më parë nuk mund të merrej me mend, rishtas njerëzit pas 15 viteve me leje C – të përhershme qëndrimi, mund ta humbin atë. Kjo është veçanërisht keq për njerëzit, të cilët janë lindur e rritur këtu. Nuk ka më leje të sigurta qëndrimi, përpos pasaportës zvicrane. Njerëzit si shoqet e shokët e mi pa pasaportë zvicrane, me të cilët unë jam rritur dhe kam shkuar në shkollë, në situatë emergjente mund të humbin lejen e tyre. S'mund të merret me mend, por reale!

Si mund të humbasin lejet e tyre?

Një kriter integrimi është «pjesëmarrja në jetën ekonomike». Kjo domethënë, që njeriu duhet të punon dhe sa më pak të mbështetet nga shteti, pra të mos kërkojë ndihmë sociale. Kjo është mjaft problematike: pritja është që njerëzit, që vijnë këtu, të japin tërë fuqinë e tyre të punës për shoqërinë. Mirëpo, kur gjenden në situatë emergjente, nuk janë më pjesë e shoqërisë, ata nuk vlejné me si «të integruar». Pas 2 vitesh apo 50000 frangave ndihmë sociale do tu hiqet leja e tyre C e qëndrimit, apo tu degradohet ajo. Që njerëzit të mos jenë më të integruar pasi marrin ndihmë sociale, është marrëzi. Të mendojmë në ata njerëz, të cilët këtu janë rritur dhe kanë shkuar në shkollë. A janë papritur ata ndryshe dhe jo më të integruar, pasi kanë ra në një situatë emergjente? Autoritetet zyrtare llogarisin vetëm se a kushtojnë diçka njerëzit. Dhe ata nuk hezitojnë të dërgojnë njerëzit në vendet, në të cilat nuk kanë asgjë dhe që në shumicën e rasteve aq që i njohin. Një perspektivë utilitare shumë egoiste mbi migracionin, që të kujton statutin e sezonierëve. Mbi të gjitha ligji është diskriminues.

Përse?

Kushtetuta federale bazohet në parimin e barazisë. Neni 8 thotë «Të gjithë njerëzit janë të njëjtë para ligjit». Kjo duket se nuk vlen për migrant*et.

Edhe ata paguajnë tatimin dhe në arkat e shëndetësisë, të AHV/AVS e IV/AI, në sigurimin e papunësisë. Mirëpo, kur është fjala për të gëzuar të drejtat e tyre. – dhe e drejta për mbështetje në rast emergjente është një e drejtë themelore e ankoruar në kushtetutë – atëherë me ligj parashihet dhe trajtohen ndryshe nga zvicran*et dhe rrezikohen të humbin të drejtën e tyre të qëndrimit. Ky trajtim papabarabartë dhe diskriminim është një thyerje a padurueshme e kushtetutës.

Ndërsa ligji mban emrin «Ligji për të huajt dhe për integrim». A nxit ai «integrimin»?

Në të vërtetë jo. Integrim për mua do të thotë inklision (gjithëpërfshirje), d.m.th. personi tjetër përfshihet dhe shoqërohet, njeriu kujdeset për atë, që ti takojë grupit. Ky parim dhe kjo mendësi për AIG/LEI është i huaj. «Integrim» në AIG/LEI domethënë më shumë masa detyruese për migrant*et: ata/o kanë obligim të integrohen, ata/o duhet të bëjnë gjithçka, për të qenë pjesë përbërëse. Dhe para së gjithash nuk duhet të jenë të kushtueshëm. Zvicran*et nga ana tjetër nuk kanë obligime, ata duhet vetëm të jenë në çikë «të hapur». Personat e huaj në një situatë emergjente ose që fitojnë më pak, në radhë të parë shihe si faktor kostoje; edhe nëse i takojnë Zvicrës, sikur ata me pasaportë zvicrane.

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Shtatzënë: A duhet të tregoi gjatë prezantimit për vend pune?

Unë aplikoi për një konkurs të shpallur pune. Par pak kohe kam mësuar që jam shtatzënë. Si është puna nëse shefi im potencial më pyet për shtatzëni të mundshme? A duhet ta njoftoi atë gjatë bisedës prezantuese?

Myriam Muff: Jo. Në të vërtetë, ju në raport me punëdhënësin tuaj potencial, që nga kontakti i pare, pra para se të keni një kontratë pune, i nënshtroheni parimin të mirëbesimit. Pra një obligim për lojalitet, sjellje korrekte. Nga kjo rezulton edhe një obligim informacioni. Nëse ky parim shkelet apo lëndohet (p.sh. nëse gjatë konkurrimit me vetëdije jepni të dhëna të gabuara mbi arsimimin tuaj), kjo mund të qojë në përgjegjësi dëmshpërblimi. E vështirë dhe në përgjithësi për të dhënë përgjigje është çështja, se deri ku duhet të shkojë obligimi i informacionit nga ana e kërkues*es të vendit të punës. Firma ka të drejtë në obligimin e informacionit që ka të bëjë me vendin e punës. Kufirin vihet tek mbrojtja e personalitetit të konkurreues*es. Mos punësimi shkaku i shtatzënisë ekzistuese parqet në parim një diskriminim gjinor në kuptimin e Nenit 3 të ligjit për barazi. Për këtë arsye firma gjatë bisedës prezantuese as që guxon të shtrojë pyetjen për shtatzëninë e mundshme. Nëse megjithatë firma e bënë këtë, ju mundeni që pyetjen ta mohoni në kuptimin e «emergjencës mbrojtëse të gënjeshtërës». Ju në parim si konkurreuese, vet nuk duhet ta bëni temë shtatzëninë tuaj. Një përjashtim vlen nëse fjala bie në rast punësimi si manekin ose balerin (vallëzuese). Në një rast të tillë pyetja mbi shtatzëni do të ishte e arsyeshme.

(Work, 20.8.2021)

Qiraja tek shefi: A guxon të ma heq qiranë nga paga?

Unë punoi qe 5 vjet si murator tek një firmë ndërtimi të cilës i takon edhe një shtëpi me qira. Unë kisha mundësinë që aty të merrja një banesë me qira relativisht të volitshme. Para pak kohësh unë dhe gruaja ime jemi ndarë dhe unë paguaj mbajtjen. Andaj kam mbet mbrapa me 2 qira mujore. Tani shefi im donë që nga paga e muajt të ardhshme të mi llogaritë qiranë për dy muajt e munguar. Kështu mua nuk do të më mbetet fare pagë. A guxon ai?

Regula Dick: Jo. Shefi juaj mund të shtrojë kërkesa dhe t'ua llogarisë në pagë, nëse nga kjo nuk bini nën minimumin e ekzistencës të paraparë nga e drejta përmbareuese. Vetëm nëse është fjala për dëme të shkaktuara me qëllim nga ana e juaj, atëherë ai do të guxonte t'ua llogarisë kompensimin e dëmit nga paga. Andaj është palignshme, që juve të mos u paguaj fare pagën. Ju duhet që tek enti i përmbaramit të vendbanimit tuaj të kërkonit të përlllogaritë minimumi ekzistencial i përmbaramit ligjor dhe pastaj t'ia shpjegoni shefit tuaj gjendjen juridike.

(Work, 3.9.2021)

Dorëheqja nga puna: A duhet që para datëlindjes së 61 të lajmërohem tek arka e papunësisë?

Unë punoi qe katër vite si shitës e një dyqan të pajisjeve elektrike. Me 3 dhjetor unë kam ditëlindjen. Mua më ka ikur dëshira për të festuar. Ndërmarrja ka lajmëruar falimentimin, punonjësve u është dhënë dorëheqja nga punë për në fund të tetorit. Unë kam drojën se në moshën time më nuk do të mund të gjej punë. Andaj, një koleg më ka këshilluar të lajmërohem menjëherë tek arka e papunësisë, për të mos pas hendek në të ardhura. A është kjo një këshillë e mirë?

Regula Dick: Jo. Ia vlen nëse me lajmërimin tuaj tek arka e papunësisë të pritni deri në datëlindjen tuaj. Nëse lajmërohni më së hershmi 4 vite para pensionimit tuaj të rregullt tek arka e papunësisë, ju përpos të drejtës së rregullt merrni edhe 120 mëditje shtesë. JU gjatë dy viteve të fundit para shkarkimit keni punuar de kështu keni fituar të drejtën për 520 mëditjet e nevojshme kontribuuese. Këtyre u shtohen edhe 120 mëditje. Kështu e drejta për mëditje tuaja është 640 ditë, dhe këto mund ti merrni deri në kohën e pensionimit tuaj. Informacione të mëtejme rreth shkarkimit nga puna dhe papunësisë mund ti gjeni tek arka e papunësisë në Unia, gjegjësisht nën <https://www.unia.ch/de/arbeitslosenkasse/haeufig-gestellte-fragen> apo <https://www.arbeit.swiss/secoalv/de/home/menue/unternehmen.html>.

(Work, 3.9.2021, angepasst)

Vendi i punës: A guxon shefi të ma ndërroi vendin e punës?

Unë jam bërë baba dhe dua të reduktoj punësimin tim në 40%. Shefi im nuk pajtohet me këtë reduktim të punës. Pos kësaj, ai dëshiron që unë rishtas të më transferoi të punoi në një vendndodhje tjetër të punës. A kam unë të drejtë në reduktim të punës? Dhe a guxon shefi im thjeshtë të ma ndryshoi vendndodhjen e punës?

Paolo Marchi: Dy herë jo. Nuk ka të drejtë të zvogëlohet marrëdhënia e punës në 40%. Fjala është për ndryshim të kontratës së punës dhe për këtë duhet të pajtohen të dyja palët. Shefi juaj megjithatë nuk guxon t'ju transferoi në një vend tjetër të punës. Edhe pse firma guxo mbi sjelljen e punonjësve në përgjithësi në ndërmarrje dhe kryerjen e punëve të lëshojë udhëzime të veçanta, mirëpo ato duhet të jenë të arsyeshme. Dhe këto udhëzime punonjësit duhet ti zbatojnë me mirëbesim. Kështu qëndron në Nenin 321 d të së drejtës obliguese zvicerane. Ndryshimi pra duhet të jetë i arsyeshëm. Dhe për ndryshimin e përhershëm të vendit të kontraktuar të punës nevojitet pëlqimi i të dyja palëve. Shefi juaj mundet që për arsye të detyrueshme operationale njëanshëm të udhëzoj ndërrimin e përkohshëm të vendit të punës, mirëpo vetëm atëherë, nëse kjo për ju marrë parasysht jetën tuaj private, posaçërisht udhëtimi për në punë është i arsyeshëm. Në rastin tuaj transferimi në një vend tjetër pune mund të vlerësohet si i paarsyeshëm.

(Work, 17.9.2021)

Marrje përgjegjësie dhe shfrytëzim rasti

Vjollca Shala gatuan përditë për shumë njerëz. Këtë mund ta arrijë vetëm nëse çdo hap i punës është i saktë. Përmes trajnimit të mëtejme profesional «Progresso» ajo fitojë këtë siguri – dhe vuri binarët për një karrierë të suksesshme profesionale në gastronominë zvicerane.

Sabine Bosshardt



Vjollca Shala trazon tenxheren, ajo përgatit drekën në shtëpinë e pleqve «Hofmatt» në Weggis. Ajo çka për te sot është bërë rutinë, para një kohe jo edhe të gjatë ka qenë provë guximi. Shqiptarja e lindur është qe 13 vjet në Zvicër, për 8 vite ka punuar në një ekip pastrimi të Migros-it, para se të fillonte punën në shtëpinë pleqve në Weggis. Aty ajo fitoi përshtypjet e para në kuzhinën gastronomike, derisa punonte në bufe. «Gatimi më fascinon» i kujtohet asaj. Aji gjithashtu pat realizuar, se më parë nuk i njihje bazat e rëndësishme të gatimit, fjala bie metodat e gatimit. «Në një shtëpi pleqsh duhet gatuar për shumë njerëz», thotë Vjollca Shala. «Gatimi domethënë gjithashtu: të marrësh përsipër përgjegjësinë».



Marrja e aftësive të nevojshme për profesionin e kuzhinës

Vjollca Shala donte të ndihej e sigurt, të kuptonte gjërat ndërlidhëse dhe të brendësonte proceset. Ajo morri guximin dhe pyeti eproren se a mund të arsimohej më tej për detyrat e kuzhinës. «Shefja ime ishte shumë kënaqur me interesimin dhe motivacionin tim» thotë Vjollca Shala. Ishte eproja e saj ajo, që pastaj e informoi mbi trajnimin profesional Progresso: me këtë u vunë binarët për një të ardhme në gastronomi. Vjollca Shala përfundoi arsimimin Progresso në vitin 2020.

Gjatë kursit arsimor, ajo herë pas here haste në fjalorin profesional që ende nuk e njihje. Vjollca Shala mund të flas mirë e

kuptueshëm, por nuk është e përsosur në gjermanisht. Mirëpo, për Progresso kjo edhe nuk është e nevojshme. Tekstet e rënda dhe detyrat e shtruara asaj ndoshta i duhej ti lexonte shumë herë, mirëpo kjo nuk paraqiste problem. «Tek Progresso merret kohë e mjaftueshme, personat mësimdhënës u përgjigjeshin nevojave tona».

Përparime të mëdha

Në javët e kursit ajo mësoi shumë. Ko shihej menjëherë në përditshmërinë e punës. Më herët kishte të madh në ditët e gatimit deh më parë parapëlqente të pastronte apo të merrte përsipër punët përgatitore për ekipin e gatimit. Tanimë gatuan me entuziazëm. «Pa hezitim ose pasiguri, pa frikë», thotë ajo.

Edhe koleget e saja mahnitëshin, se sa kishte mësuar ajo në një kohë kaq të shkurtër, kuzhinierët vlerësojnë shumë mbështetësen e re. «Ky ishte një kurs i shkurtër me një efekt të madh» thotë me krenari Vjollca Shala. Ajo nga kursi përfiton njohuri të reja. Si kujtim shumë i mbetet ceremonia e diplomimit, në të cilën absolutetë me krenari prezantonin specialitetet atdheu i tyre. «Na dhamë gjithçka nga vetja jonë» kujtohet Vjollca Shala duke qeshur. Ajo kontribuoi me pite e byrek, suxhuk dhe specia të mbushur nga kuzhina shqiptare.

Hapi i parë drejt suksesit

Vjollca Shala perceptoi përvojat e saja në Progresso aq pozitivisht, sa filloi të interesohet edhe për kurset tjera arsimore. Ajo dyshonte se aftësitë e saj gjuhësore ishin të mjaftueshme. Por, mësuesja e kursit Progresso Paula Elmiger e motivonte për të provuar. Në ndërkohë Vjollca Shala është duke ndjekur vitin e parë të arsimimit të shkurtuar modular të punonjësës së kuzhinës me certifikatë profesionale federal (EBA) dhe ëndërron që më pas të bënë edhe certifikatën federale të aftësisë EFZ. Progresso për te ishte hapi i parë drejt suksesit. Ajo tashmë u ka rekomanduar kursin edhe disa koleg*eve që janë duke punuar në gastronomi. Në fund të fundit, Progresso është diçka nga më të mirat që ajo ka bërë për të ardhmen e saj. «Është një shans që thjesht duhet shfrytëzuar.»

www.mein-progresso.ch